



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 712/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbare të kreditorit “A...” sh.p.k., me nr. të biznesit ..., me seli në fshatin ..., Komuna e Graçanicës, përfaqësuar nga Sabri Kryeziu, avokat në Lipjan, rr. “Mbreti Zog” nr.5, kundër debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (Kesco) sh.a, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021 të Përmbaresit Privat Emine Sherifi – Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (Kesco) sh.a, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021 të Përmbaresit Privat Emine Sherifi – Lubeniqi, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat Emine Sherifi – Lubeniqi, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “A...” sh.p.k, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik III. Ek.nr.26/20 të dt. 11.01.2021, ka nxjerrë urdhrin P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbaremit, ndaj debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (Kesco) sh.a, me seli në Prishtinë dhe ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin, në emër të shpenzimeve procedurale në shumë prej 1.921.40 € (një mijë e nëntëqind e njëzet e një euro e dyzet cent) si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbare për propozim për përmbare në shumën prej 156.00€ (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro) dhe shpenzimet tjera sa do të caktohen nga ana

e përmbaruesit privat ku urdhërohen bankat komerciale që veprojnë në Kosovë, që menjëherë posa ta marrin këtë titull përmbarimor, nga xhirollogaritë e debitorit që janë të hapura në këto banka, ti bartin mjetet materiale për të cilat është lejuar përmbarimi, në xhirollogarinë rrjedhëse nr..... e cila llogari është e hapur në “.....”, me seli në Prishtinë.

Debitori në prapësimin e paraqitur ka deklaruar se meqenëse dokumenti i bashkëngjitur propozimit për përmbarim si provë të emëruar në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm, me qëllim të identifikimit të debitorit nuk përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 38 par 2 të LPP –së, organi përmbarues duhet të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit, ndërsa të anulohet urdhri për përmbarim P.nr.278/21 dt. 27.10.2021, i Përmbaruesit Privat Emine Sherifi – Lubeniqi, si i pa lejuar dhe i pa bazuar në ligj, duke e detyruar kreditorin edhe në pagimin e shpenzimeve procedurale.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ndër të tjera ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se i njëjti nuk mbështetet në asnjërin nga shkaqet e paraqitjes së prapësimin të cilat janë të renditura në mënyrë taksative në nenin 71 të LPP –së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitori kundër urdhrit P.nr.278/21 të dt. 27.10.2021 të refuzohet si i pa bazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi. Si dhe të detyrohet kreditori në pagimin e shpenzimeve procedurale dhe atë për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 156 € (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, me seli në Prishtinë, e ka pranuar me datë 27.10.2021, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 08.11.2021.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se “ *Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues*”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se “ *Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.*”

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbartimor P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021, e ka pranuar me datën 27.10.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimi ka filluar të rrjedhë nga data 28.10.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimi ka qenë data 03.11.2021.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 08.11.2021, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të përmbartuesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me pesë ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 712/22, datë 02.09.2022.

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.